

Pas shqyrtimit të kësaj çështje dhe nga dokumentacioni i disponuar, rezulton se:

Shtetasi R.T me vendimin nr.620 datë 31.03.2017, është deklaruar nga KMCAP-i Tiranë me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.04.2017-01.04.2018. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, është pajisur me vërtetim *“Për invaliditet të plotë nga sëmundje të përgjithshme”* me nr.3928 datë 12.06.2017, me anë të të cilëi vërtetohet se pensioni i invaliditetit (të plotë) e përfiton për periudhën 01.04.2017-01.04.2018.

Nga korrespondenca që ankuesi ka patur me Njësine tuaj Administrative, i është kthyer përgjigje më datë 22.06.2017 se:

“... Sipas vërtetimit tip të sjell nga ana juaj në institucionin tonë, data e daljes në komision është 12.06.2017 dhe pagesa e paaftësisë për ju fillon një muaj pas kësaj date, pra ju lind e drejta e përfitimit të kesaj pagese nga data 01.07.2017..”.

Sjellim në vëmendjen Tuaj, se për shqyrtimin e kësaj çështje, institucioni ynë ju është drejtuar me një kërkesë për të na saktësuar datën e dhënies së vendimit të KMCAP-it Tiranë. Në përgjigje të kërkesës sonë, me shkresën tuaj nr. 2553/3 datë 14.08.2017, ndër të tjera, na keni informuar se *...Sipas vërtetimit tip, data e komisionimit është 12.06.2017 dhe pagesa e paaftësisë i ka filluar një muaj pas kësaj date, pra i ka lindur e drejta e përfitimit të kesaj pagese nga data 01.07.2017..”.*

Zoti Merko,

Data e daljes në komisionin mjekësor është 31.03.2017 dhe jo 12.06.2017. Kjo datë është data e dhënies së vërtetimit tip nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e cila vërteton se shtetasi R.T është përfitues i pensionit të invaliditetit për periudhën 01.04.2017 – 01.04.2018.

Në analizë të akteve ligjore e nënligjore për përfitimet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, të cilët janë invalidë pune, konkretisht të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18,06,2008 *“Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, pika 1/a, personave përfitues, sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit nr. 7889 datë 14.12.1004 “Për Statusin e Invalidit”, të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësi, në masën:*

-3300 lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme...’

Udhëzimi nr.1406 datë 30.07.2008 *“Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18,06,2008 “Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, në pikën 5 ka përcaktuar se:*

“5. Për personat që komisionohen për herë të parë dhe përfitojnë statusin e invalidit të punës, pagesa e paaftësisë fillon në muajin pasardhës pas daljes në KMCAP të përcaktuar sipas vërtetimit tip, në pikën 2 të këtij udhëzimi”

Sipas këtij akti nënligjor, Vërtetimi Tip i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka përcaktuar fillimin e periudhës së invaliditetit që është 01.04.2017 dhe jo data 12.06.2017.

Pra, arrihet në konkluzionin se kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar, si shtesë mujore mbi pensionin e imnvaliditetit për periudhën 01.04.2017-01.07.2017.

Për sa më sipër, me qëllim që ankuesi të përfitojë të drejtat e tij ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

R E K O M A N D O J M Ë

Marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, shtetasit R.T për periudhën 01.04.2017-01.07.2017.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI